REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës:	2019:265931
Datë:	13.01.2021
Numri i dokumentit:	01404724

A.nr.10/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit P.shpk me seli në Gj., kundër të padituresë Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 12.01.2021, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHETKërkesëpadiae paditësit P.shpk me seli në Gj.

ANULOHET Aktvendimi nr.01.3.2.2/625, 689 datës 30.11.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve nr. R-21439/19.09.2018, R-21661/21.09.2018, R-22146/22.09.2018, R-22257/27.09.2018, R-22444/28.09.2018, R-22549/29.09.2018, R-23135/06.10.2018, R-23387/09.10.2018, R-23509/10.10.2018, R-23618/11.10.2018, R-23484/13.10.2018, R-24063/16.10.2018, R-24277/18.10.2018, R-24755/23.10.2018, R-24928/25.10.2018, R-25119/26.10.2018, R-25102/26.10.2018, R-25271/29.10.2018, R-25754/01.11.2018, R-25860/02.11.2018, R-26070/05.11.2018, R-26069/05.11.2018, R-26183/06.11.2018, R-26274/07.1.2018, R-26395/08.11.2018 të lëshuar nga ZBD Ferizaj, si e pa bazuar.

Paditësi P.shpk me seli në Gj., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 03.01.2019, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të padituresë Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të aprovohet padia në tërësi si e bazuar, të anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/625,689 i datës 30.11.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, si dhe të obligohet Dogana e Kosovës që të bëj kthimin e mjeteve të paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit të paguara më tepër mbi vlerën e transaksionit.

Në padinë e tij dhe përmes të autorizuarit në seancën kryesore, paditësi deklaron:me anë të Deklaratave doganore, importuesi ka deklaruar për doganim mallin banane të gjelbra, të freskëta të papjekura, sipas dokumenteve të bashkangjitura. Me rastin e deklarimit për doganim paditësi ka poseduar dhe ka prezantuar para zyrtarëve doganor të gjitha dokumentet e nevojshme të transaksionit

2019:265932

për përllogaritje të obligimeve, mirëpo ZD Dheu i Bardhe dhe ZBD Ferizaj, kanë kontestuar vlerën transaksionale të këtyre mallrave, përkatësisht kanë vepruar në bazë të listës së çmimeve të përcaktuara nga Dogana e Kosovës, e obligueshme me rastin e paraqitjes së mallrave për doganim. Ekziston shkelja e dispozitave ligjore e dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave, nga shkaku se nuk është zbatuar në mënyrë adekuate dispozita ligjore përkatësisht neni 33 i tij. Importuesi edhe pse ka prezantuar këto dokumente, prapëseprapë zyrtaret doganor kanë bërë kontestimin e vlerës së mallit. Importuesi ka prezantuar dokumentet e nevojshme të cilat janë të parapara për shoqërimin e mallrave të destinuara për import të cilat përcaktohen me Kodin Doganor dhe të Akcizave dhe me Udhëzimin Administartiv, sikurse janë: faturat lëndore, urdhërpagesat bankare në emër të faturave, kontratat e shitblerjes se mallrave dt.21.09.2018 dhe 02.10.2018. E paditura fare nuk e ka vlerësu këtë dokumentacion mirëpo me rastin e refuzimit të ankesës është mbështetur vetëm në një urdhëresë të brendshme të Doganës e cila nuk është në përputhje me Kodin Doganor dhe të Akcizave.I autorizuari i paditësit në shqyrtimin gjyqësor deklaron**:** deklarimin për këtë seancë e kam përgatitur në formë të shkruar, dhe të njëjtën ia dorëzoj gjykatës së bashku me DUD-at kontestues, faturat e mallrave lëndore, Urdhërpagesat bankare në emër të faturave, si dhe kontratat e shitblerjes së mallrave të cilat i janë bashkangjitur edhe ankesës tek e paditura. Po ashtu gjykatës i dorëzoj një kopje edhe dy Aktgjykime me të cilat kjo Gjykatë ka vendosur për paditësin e njëjtë dhe për mallrat e njëjta. Duke marrë për bazë të theksuarat dhe provat e administruara, i propozoi gjykatës që të aprovoi kërkesëpadinë në tërësi të bazuar, ashtu që të anuloi aktvendimin e atakuar, dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

E paditura në përgjigje në padi datës 29.05.2020 dhe përmes të autorizuarit në seancën gjyqësore deklaron: e kontestojmë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispziotave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marre konform legjislacionit në fuqi dhe ne mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një prove të vetme. Në seancën gjyqësore përfaqësuesi i autorizuar deklaron: mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi të paraqitur në lidhje me këtë kontest. Konsiderojmë se e paditura ka vepruar drejtë kur mallin kontestues e ka vlerësuar në përputhje me dispozitat e nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, përkatësisht në metodën e gjashtë të vlerësimit të mallit. Pretendimet e ngritura nga ana e paditësit me këtë padi janë shqyrtuar në fazën e ankimimit nga ana e të paditurës, dhe për faktin se paditësi nuk ka arritur me prova të mjaftueshme të vërtetoi pretendimet e tij, ka ardhur edhe deri tek refuzimi i ankesës. Andaj mbi bazën e të theksuarave si më sipër, që nuk janë të prezantuara prova të tjera me të cilat do të provoheshin pretendimet e ngritura në këtë padi, i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta refuzoi në tërësi si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës: 12.01.2020, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e dt. 29.05.2020 e Doganës së Kosovës, Aktvendimi nr.01.3.2.2/625,689 i dt.30.11.2018 i Doganës së Kosovës, Ankesa e paditësit nr.prot.625/18.10.2018, Deklaratat Doganore, Fakturat e mallit, Transferet Bankar, Kontratat e shitblerjes së mallrave, Specifikacioni për mallin lëndor, Deklarimi me shkrim i të autorizuarit të paditësit, 2 Aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 12.01.2021, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në ankes-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar andaj vendosi që lëndën ta kthej në rishqyrtim për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, Gjykata ka nxjerr konstatimin se paditësi ka deklaruar mallin për zhdoganim në Zyrën e Brendshme Doganore Ferizaj, me ç‘rast pas pranimit

dhe vlerësimit të DUD-ave kontestues, Dogana e Kosovës e ka rivlerësuar mallin lëndor ne bazë të metodës së gjashtë (6) te vlerësimit ne pajtim me nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, respektivisht në bazë te dhënave te disponushme Dosja e Vlerës, dhe ne këtë rast subjekti në procedurë-paditësit i është ngritur baza doganore, dhe është detyruar qe te paguaj takse doganore me te larte se te deklaruar me faturat e mallit.

Gjykata nga ekzaminimi i arsyetimit të vendimit kontestues ka konstatuar se vendimi është i bazuar ne Urdhëresën Administrative nr. 189/06.05.2016, në të cilën theksohet se palët janë të obliguar që pemët dhe perimet ti deklaron ne baze te çmimit te përcaktuar ne dosje te vlerës, ndërsa e paditura për rivlerësimin e mallit lëndor ka përdoruar dosjen e vlerës si të dhëna te disponueshme. Gjykata nuk mund të pajtohet me një qëndrim juridik të dhënë ne vendimin kontestues, për arsye se, aplikimi i një urdhërese të tillë nga e paditura bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave, dhe Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për zbatimin e Kodit Doganor dhe Akcizave, ku shprehimisht parashihen, dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë te mallit,fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti, lidhur me nenin 33 te Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata e konsideron të papranueshëm dhe arbitrar një arsyetim të tillë të vendimit kontestues, ku e paditura nuk shqyrton asnjë pretendim të paditësit gjatë procedurës ankimore. Mos arsyetimi i provave të paraqitura nga paditësi është në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 pika 1.5 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që parasheh:Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve. Gjithashtu e paditura me rastin e vendosjes në procedurën ankimore, nuk ka respektuar dispozitat e nenit 134 të Ligjit 05/L-031 të njëjtit Ligj, që parasheh: Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë gjithashtu vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.

Paditësi i ka paraqit gjykatës provat materiale si: Deklaratat Unike, faturat e mallit doganor, pagesat bankare, deklaratat eksportuese, kontratën e shitblerjes, fakte këto të cilat e paditura fare nuk i ka shqyrtuar apo kontestuar në procedurën administrative të ankesave.

Me qëllim të konstatimit të drejt të çështjes, me prova materiale shtesë, lidhur me kontestin e vërtetësisë së dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, gjykatës i duhet sqarim plotësues, verifikim dhe sigurim i provave shtesë, në mënyrë që konstatimi i dhënë në arsyetim të aktvendimit të kontestuar të mbështetet në prova materiale. Gjykata kërkon nga e paditura Dogana e Kosovës që në ri procedurë para se të vlerësoj mallin doganor nga dosja e vlerës, të verifikoj vërtetësinë e dokumentacionit përcjellës të mallit në aspektin e harmonizimit të vlerës së mallit të deklaruar, ashtu që të shqyrtoj pretendimet e paditësit se ka prezantuar dokumentet e nevojshme që kërkohen me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 mbi implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, të verifikohet vlera e paguar e faturave, transfereve bankare, deklaratave eksportuese dhe kontratës së shitjes. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallit.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipërcekura, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ku ka rezultuar të mos dihen arsyet e mos kontestimit të vërtetësis së dokumentacionit të mallit të prezantuar në procedurën administrative të ankesave.

Andaj në këtë drejtim gjykata bazuar në autorizimet nga nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102, neni 43 par.2 të LKA-së e detyron organin e paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejt faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë të çështjes.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative/Divizioni Fiskal
A.nr.10/2019 datë 12.01.2021

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KESHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.